



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 2 datë 22 / 09 / 2017

“ Për

**Miratimin e “Rinovimit të Lejes për përdorim të burimeve ujore për proces teknologjik”,
Subjekti “Ballej-A”sh.p.k”.**

Në mbështetje të neneve 7 pika 2 , nenit 50, 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” , vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe kërkesës së subjektit “Ballej-A” sh.p.k, me propozim te A.B.U. Mat;

Këshilli i Basenit Ujor Mat;

V e n d o s i:

1. Miratimin e “ Rinovimit të Lejes për përdorim uji për proces teknologjik”, për uzinën e Ferrokromit në njësinë Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Ballej-A” sh.p.k me administrator z. Klodian Koxherri, me këto të dhëna:

-Vendndodhja e burimit ujor: Përroi i Thekrës, Lumi Mat në njësinë Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

-Prurja mesatare vjetore: **26.3m³/s**

-Sasia e ujit për përdorim: **0.007 m3/s**

- Koordinatat e marrjes:

X – 45 87 489

Y- 44 36 945

Z -1000

- Koordinatat e shkarkimit:

X – 45 87 496


Y- 44 36 847

2. Ngarkohet A.B.U. Mat për zbatimin e këtij vendimi .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA

